# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-473999**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | "Dy djemtë më vodhën çantën te Sky Club, dua vetëm dokumentet e shtatzënisë" |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1394500.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 14:12:05 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 27 shtator 2026, 14:01:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 27 shtator 2026, 14:00:00 UTC → 27 shtator 2026, 14:02:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `035bbd74ef5a98f319e70520a7a328112185177dc7345f6a87f7677684bf56bf` |
| TEKSTI | `177243848d1ef006ffd800bdf879c5994bcc007cbb4bfb196ce741302e7db087` |
| PAMJA | `afef5318e47b458dc213a1ead9d04daf322759615e371b9aeda701163450e6c9` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `43f63510de37009ff7077f0be30502de10edbd79a709369d2043f1b634a10d3f` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `9def72ec67cc19e19d7afdb89aaceb893ee05eec68643756bafa9738daebd45d` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/43f63510de37009ff7077f0be30502de10edbd79a709369d2043f1b634a10d3f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# “Dy djemtë më vodhën çantën te Sky Club, dua vetëm dokumentet e shtatzënisë”

Shkruar nga: I Cani | Publikuar më: 27.09.2026, 16:01

Share Share




Një qytetar i është drejtuar JOQ Albania me një denoncim për një vjedhje të pretenduar që, sipas tij, ka ndodhur mbrëmjen e kaluar në ambientet e Sky Club, te Tringu.

Ai pretendon se dy persona i kanë marrë çantën, brenda së cilës ndodheshin sende personale dhe portofoli me dokumente.

Por ajo që e shqetëson më shumë nuk janë paratë apo kartat bankare, të cilat thotë se tashmë i ka bllokuar, por disa dokumente të lidhura me shtatzëninë, të cilat sipas tij ndodhen në një kartë dhe janë të rëndësishme për të ndjekur ecurinë e shtatzënisë.

“Më intereson vetëm portofoli me dokumentet. Janë disa dokumente vendimtare për shtatzëninë”, shprehet qytetari, duke kërkuar që personat që e kanë marrë çantën t’ia kthejnë dokumentet.

Ai pranon se çanta mund të jetë harruar nga pakujdesia, por thekson se, sipas tij, personat nuk e kanë gjetur rastësisht në rrugë, por e kanë marrë dhe e kanë futur brenda një çante tjetër.

Qytetari thotë se po përgatitet të ndjekë edhe rrugën ligjore dhe se denoncimi pranë organeve kompetente pritet të bëhet.

Apeli i tij është i drejtpërdrejtë: nëse çanta është marrë nga dikush, të paktën dokumentet e shtatzënisë të kthehen, pasi për të ato kanë një rëndësi që nuk zëvendësohet thjesht duke nxjerrë përsëri një kartë identiteti apo patentë.

Nëse dikush i ka gjetur apo ka informacion për çantën dhe dokumentet, qytetari kërkon që t’i dorëzohen, përpara se çështja të ndiqet në rrugë ligjore.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t’i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

## TË NGJASHME



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.